



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin mars 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim informimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit mars 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Prezenca gjatë organizimit të panairit "Agro Tech" këtë muaj na mundësoi vendosjen e kontakteve me shumë sipërmarrës, duke nxitur gjithësecilin për të qenë pjesë e komunikimit tonë të vazhdueshëm përmes shoqatave të biznesit apo dhomave të tregtisë.

Ndërkohë me kënaqësi kemi mbështetur ngritjen e clusterit të parë në vendin tonë, Clusterin e Industrisë së Drurit, që është një eksperiencë e cila duhet promovuar edhe në sektorët ose industritë e tjera më qëllim nxitjen e konkureshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet e huaja.

Vazhdojmë të kemi fokus të veçantë të trajtimi i ankesave të biznesit duke koordinuar punën dhe veprimtarinë midis institucioneve, për të nxitur rritjen e performances së tyre në komunikimin e vazhdueshëm me sipërmarrjen dhe zgjidhjen e problematikave.

Në vijim të takimeve me shoqatat e biznesit, veçanërisht me Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri, kemi identifikuar tipologjinë e problematikave me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në nivel sektorial.

Duke shpresuar në vijimin e krijimit të urave të qëndrueshme të komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se në këtë mënyrë mund të përmirësojmë klimën e biznesit në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 1	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesit	03.10.2018	Subjekti kërkon informacion në lidhje me trajtimin e inputeve bujqësore që ka gjendje përpara ndryshimeve ligjore të janar 2019 që përjashtojnë inputet bujqësore nga TVSH-ja.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 2	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	15.10.2018	Subjekti kërkon të denoncojë rastin e hyrjes së një malli kontrabandë	Trajtuar me përgjigje
Nr. 3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	16.10.2018	Subjekti kërkon të denoncojë një karburant që është në pronësi të një punonjësi të administratës publike.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	18.10.2018	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me një interpretim teknik që ka kërkuar për të cilin nuk ka marrë një përgjigje sqaruese.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 5	Drejtoria e Apelit Tatimor	23.10.2018	Subjekti ankohet për gjobëvënie të pajustificuar.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 6	Ministria e Financave dhe Ekonomise	23.10.2018	Subjekti kërkon heqjen e akcizës përse i përket baterive dhe gomave të automjeteve.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 7	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	01.11.2018	Subjekti ankohet për mos-rimbursimin e TVSH-së brenda afateve ligjore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	15.11.2018	Subjekti kërkon informacion në lidhje me projekte dhe grante për sektorin e bujqësisë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 9	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural / Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	17.11.2018	Subjekti ankohet për kontrolle të vazhdueshme dhe gjobëvënie të pa-arsyeshme nga AKU	Trajtuar me përgjigje
Nr. 10	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	17.11.2018	Subjekti ankohet në lidhje me mjetet e pa-licensuara që kryejnë transporte udhëtarësh.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 11	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	27.11.2018	Subjekti ankohet për trajtimin si i tatueshëm për arsye TVSH-je dhe gjoba të larta.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 12	Ministria e Brendshme	06.12.2018	Subjekti ankohet në lidhje me Urdhrin e perbashket nr.661 date 12.12.2018 te MB, MM dhe MFE "Per ndalimin e hedhjes ne treg te lendeve piroteknike dhe fishekzjarrve per perdorim civil, qe rrezikojne sigurine publike, jeten dhe shendetin e njerëzve".	Në proces
Nr. 13	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	13.12.2018	Subjekti ankohet për presione dhe gjobëvënie pa arsye nga ana e inspektorëve të hetimit tatimor.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 14	Drejtoria Rajonale Tatimore	18.12.2018	Subjekti ankohet për gjobëvënie të padrejtë nga ana e inspektorëve tatimore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 15	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	26.12.2018	Subjekti ankohet për problematikat e hasura në lidhje me birrat e importuara dhe shqetësimet që lidhen me konkurrencen me birrat vendase.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 16	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makroekonomisë Çështjeve Fiskale dhe Punësimit	27.12.2018	Subjekti ankohet për vendosjen e taksës së plastikës në mënyrë të padrejtë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	04.01.2019	Subjekti ankohet për vendosjen e taksës së plastikës në mënyrë të padrejtë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 18	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	07.01.2019	Subjekti ankohet për sjellje të papranueshme nga ana e një konsulli nderi.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 19	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	09.01.2019	Subjekti ankohet mbi sjelljen e nënpunësve tatimorë.	Në proces
Nr. 20	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	11.01.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një mospërputhje në lidhje me statusin në QKB dhe statusin në tatime të biznesit, si dhe gjenerimi i gjobave të shumta lidhur me këtë mospërputhje.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 21	Bashkia Shkodër	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim apo sugjerim të procedurave që duhet të ndjek në lidhje me transportin urban.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 22	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	15.01.2018	Subjekti ankohet për mosmarrje vërtetimi për shlyerje detyrimesh të DPT duke qënë se sistemi i tatimeve nuk i njuh pagesat e kamatëvonesave.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 23	Qendra Kombëtare e Biznesit	16.01.2019	Subjekti kërkon shpjegim nëse aktivitetet e klinikës, parukerisë, avokatisë nuk do të lejohen të ushtrohen në apartamente që kanë ndryshuar destinacionin.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 24	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore	17.01.2019	Subjekti ankohet se Bashkia e Tiranës ka kryer një bllokim në lidhje me detyrime të një biznesi që biznesi pretendon të jetë mbyllur përpara shfaqjes së detyrimeve.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 25	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	17.01.2019	Subjekti ankohet për zhdoganimin e një automjeti pranë doganës.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 26	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	17.01.2019	Subjekti kërkon të hapë një nipt të ri ndërkohe që nipti i vjetër rezulton me detyrime të pashlyera.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 27	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	30.01.2019	Subjekti pretendon se është fituar në mënyrë të padrejtë koncensionin i një zone naftë-mbajtëse në Fier.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.01.2019	Ankese kundrejt ndryshimeve të ligjit Nr. 9975, Dt 28.07.2008, " Per Taksat Kombetare"	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 29	Inspektoriati i Mjedisit	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Në proces
Nr. 30	Bashkia Tirane	06.02.2019	Subjekti pretendon shkelje procedure nga ana e punonjësve të Bashkisë përse i përket pagesave në bankë	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 31	QKB	07.02.2018	Shoqeri te Cregjistruar ne QKB, Administrata Tatimore nuk ka bere cregjistrimin ne sistemin tatimor sipas Ligjit Nr.33/2017 pasi nuk kane marre informacion nga QKB	Trajtuar me zgjidhje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 32	Bashkia Durrës	11.02.2019	Subjekti ankohet për mos marrjen e licenses në lidhje me transportin e pasagjerëve.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 33	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.02.2019	Subjekti kërkon ndryshim ligjor në lidhje me taksën e ambalazhit për produktet e polisterolit.	Në proces
Nr. 34	Drejtoria Përgjithshme Tatimore	13.02.2019	Subjekti ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së por nuk ka marrë përgjigje.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 35	Bashkia - Qarku Korçe	15.02.2019	Subjekti kërkon asistencë financiare për fonde nga ana e institucioneve publike për të hapur një veprimtari biznesi	Në proces
Nr. 36	Dogana Lushnje	18.02.2019	Subjekti kërkon zhdoganimin e makinerive bujqësore pa TVSH në perputhje me ndryshimet ligjore, në mungesë të VKM-së që përcakton dispozitat zbatuese të Ligjit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 37	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	19.02.2019	Subjekti kërkon mbrojtjen e të drejtës së ekskluzivitetit si dhe moscenimin e sigurisë ushqimore.	Në proces
Nr. 38	Enti Rregullator i Ujit	19.02.2019	Subjekti kërkon mosfaturimin e sasisë së ujit nga një njësi administrative vendore drejt një njësie administrative tjetër.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 39	Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit	19.02.2019	Ankim ndaj sjelljes së Agjensisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtorisë së Inspektimit, Monitorimit dhe Sherbimeve Publike	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 40	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	19.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një rivlerësim të vlerës doganore nga ana e doganës.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 41	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20.02.2019	Subjekti ankohet se i kërkohet pagesa për dy vite në lidhje me kasën fiskale ndërkohë që ka kryer përditësimin e kasës fiskale.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 42	Bashkia - Qarku Fier	20.02.2019	Subjekti kërkon shëmbjen e një garazhi para ndërtesës ku ndodhen zyrat e subjektit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 43	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me gjobat e papaguara të një biznesi që ka falimentuar dhe është mbyllur në 2014. Subjekti nuk mund të hapë një biznes të ri për shkak të gjobave të prapambetura.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 44	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.	20.02.2019	Subjekti kërkon rishikimin e procedurave që duhet të ndjek një biznes në lidhje me inspektoriatin e punës si dhe listën e dokumenteve të detyrueshëm që duhet të mbajnë subjektet.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 45	Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë	20.02.2019	Problematike me shërbimin e pa paguar të emergjencës	Trajtuar me përgjigje
Nr. 46	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.02.2019	Në lidhje me HEC Treska 1, Korçë, HEC Rehovë, Kolonjë, deleguar dhe në pritje nga MIE	Trajtuar me zgjidhje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 47	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.02.2019	Shoqeria Cekrezi 2014" operon qe nga 19.03.2009 ne linjen Librazhd-Divjake-Librazhd. Ne 2017 rinovova licensen me nr 370 e vlefshme deri ne 15.08.2022 ne Ministrine e transportit. Ne Gusht 2018 u nderpre puna dhe u hoq linja nga sistemi pa asnje arsye.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 48	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.02.2019	Subjekti kërkon Zbardhien e projektit të Ndërtimit të Centralit Elektrik Fotovoltaik në përputhje me autorizimin për prodhim energjie elektrike.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 49	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	20.02.2019	Ankesë në lidhje me mbrojtjen e bizneseve si the kostot për mallrat e importit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 50	KPP	22.02.2019	Mbi proceduren e prokurimit me objekt "Prishje i ish Frigoriferit ne Vlore", ankuesi shprehet se KPP nuk pranon ankesën e tyre.	Ne proces
Nr. 51	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	22.02.2019	Subjekti ankohet për pjesmarrje në proceduren konkurruese leje kërkim-zbulimi.	Në proces
Nr. 52	Drejtoria e Rimbursimit te TVSH	25.02.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH brenda afateve ligjore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 53	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	26.02.2019	Ankesë për mos likuidim e barërave të rimbursueshme nga FSDKSH.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 54	AIDA	26.02.2019	Kërkohet informacion në lidhje me mundësitë që ofrohen nga shteti përsa i përket financimit të bizneseve të reja.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 55	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	27.02.2019	Subjekti ankohet për vonesë në rimbursimin e TVSH-së	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 56	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	27.02.2019	Subjekti ankohet për vonesë në rimbursimin e TVSH-së	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 57	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	27.02.2019	Subjekti kërkon mos-pagesën e kontributeve shoqërore për të cilat pretendon se nuk ka detyrim pagese.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 58	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave & Ministria e Financave dhe Ekonomisë	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivleresimin e deklarave doganore.	Në proces
Nr. 59	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	04.03.2019	Subjekti ka kërkuar rikthimin e linjes Librazhd-Divjake nga MIE.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 60	Drejtoria e Standardeve Profesionale	05.03.2019	Subjekti ankohet ndaj Drejtorisë së Antiterrorit në lidhje me një prokurim publik për të cilin pretendon se duhet të ishte shpallur fitues.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 61	Bashkia Shkodër	07.03.2019	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me shkresën e dërguar në Bashkinë e Qarkut Shkodër.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 62	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10.03.2019	Subjekti pretendon se automjete të pa licencuara për transport udhëtarësh i bëjnë konkurrence të pandershme.	Në proces
Nr. 63	Ministria e Drejtësisë	10.03.2019	Subjekti kërkon legalizimin e objektit ku ushtron aktivitetin bar-kafe.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 64	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11.03.2019	Subjekti kërkon zgjidhjen e problematikës në lidhje me ndërprerjen e energjisë elektrike prej 5 orë në ditë duke qënë se gjithë fabrikat janë me 20,000 kw përveç fabrikës në fjalë që operon me 6000 kw.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 65	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	12.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me penaltetet abuzive të vendosura nga DPT.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 66	Agjensia Kombëtare e Turizmit	13.02.2019	Subjekti kërkon likuidim të detyrimeve kontraktuale nga AKT.	Në proces
Nr. 67	Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	13.03.2019	Subjekti kërkon rishikimin e punimeve në një rezervuar pasi nuk kanë hapur puseten e shkarkuesit fundor, që do të pastronte rezervuarin nga dherat.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 68	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	13.03.2019	Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të caktuara	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 69	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	15.03.2019	Subjekti ankohet për kushte diskriminuese për lejimin e ushtrimit të profesionit arkititekt dhe inxhinier.	Në proces
Nr. 70	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	13.03.2019	Subjekti kërkon hapjen e një nipti sekondar nga Drejtoria Doganore.	Në proces
Nr. 71	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	15.03.2019	Subjekti kërkon rishikimin e kërkesës për punësimin e një inxhinieri mekanik pranë servisit të tij duke qënë se nuk ofron shërbime të tilla.	Në proces
Nr. 72	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	16.03.2019	Subjekti ankohet për gjobitje të padrejtë nga ana e DPT.	Në proces
Nr. 73	Bashkia Durrës	18.03.2019	Subjekti kërkon pagesën e detyrimeve të prapambetura nga ana e Bashkisë Durrës për punimet e kryera nga subjekti në vitin 2014.	Në proces
Nr. 74	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	18.03.2019	Subjekti ankohet për vendosjen e kriterëve diskriminues për pjesëmarrjen në tender.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 75	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20.03.2019	Ankesë për vonesë në rimbursimin e TVSH-së	Në proces
Nr. 76	Drejtoria Rajonale Doganore- Tiranë	20.03.2019	Subjekti dëshiron të eksportoje produkte ushqimore me kohëzgjatje të shkurter dhe për pasojë kërkon informacion mbi lehtësimin e procedurave doganore për të përshpejtuar zhdoganimet.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 77	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	21.03.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e fidanëve të shafranit në listën e inpueteve bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja.	Në proces
Nr. 78	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	21.03.2019	Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të caktuara ligjore.	Në proces
Nr. 79	Ministria e Drejtësisë	26.03.2019	Subjekti kërkon regjistrimin pranë ZVRPP	Në proces
Nr. 80	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	27.03.2019	Subjekti ankohet për vonesë prej tre muajsh për rimbursimin e TVSH-së.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 81	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	27.03.2019	Kerkesë në lidhje me mospajisjen me licensë për servis in e automjeteve.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 82	Drejtoria Rajonale e Tatimeve- Berat	28.03.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së kreditore.	Në proces
Nr. 83	Bashkia Elbasan	29.03.2019	Subjekti kërkon asistencë për zbardhjen e Lejes së Ndërtimit të aprovuar në 2007 nga Bashkia e rrethit Elbasan.	Në proces

